



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Tiranë më

Nr.

protnumber

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN
PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR KRIJIMIN E QENDRAVE TË POSAÇME TË
VOTIMIT, HARTIMIN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE DHE KRIJIMIN E
KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT NË INSTITUCIONET E
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
VETËQEVERISJES VENDORE.

**1. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME
LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Referuar nenit 20 pika 1, shkronja “a”, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projekt akte me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

Neni 43 i Kodit Zgjedhor përcakton se KZAZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe me udhëzimet e KQZ-së, i propozon KQZ-së krijimin e KQV-ve të posaçme në institucionet e posaçme. Ne mungese të një udhëzimi si dhe diktuar nga vendimi nr. nr.28 date 15.06.2023 i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor synohet të përcaktohen rregullat për krijimin e qendrave të posaçme të votimit në IEVP.

Duke vlerësuar se vendimi i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor ishte për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, vlerësohet nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë së është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

2. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim vjen si një nevojë emergjente për të rregulluar procedurat e votimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), duke nxjerrë mësim nga zgjedhjet vendore të vitit 2023. Konflikti juridik i konstatuar nga Kolegji Zgjedhor në rastin e Rrogozhinës ekspozoi vakuumin dhe pasaktësitë në hartimin e listave të zgjedhësve dhe legjitimitetin e krijimit të qendrave të posaçme të votimit.

Objektivi kryesor i projektvendimit është harmonizimi i procedurave ndërmjet Kodit Zgjedhor dhe ndryshimeve të fundit në Ligjin për Gjendjen Civile (Ligji 56/2024), duke garantuar që procesi të mos cenohet nga interpretimet mbi vendbanimin dhe afatet kohore.

Kjo kërkon krijimin e qendrave të posaçme të votimit dhe hartimin e listave të zgjedhësve për rreth 3030 te burgosur ne këto institucione (të dhëna të mbështetura për procesin zgjedhor e 11 majit 2025).

Projektvendimi përcakton rregullat dhe procedurat për krijimin e qendrave të posaçme të votimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), hartimin dhe administrimin e listës së zgjedhësve në këto institucione, si dhe krijimin e komisioneve të qendrës së votimit (KQV).

Ai përcakton rregullat dhe procedurat për krijimin e qendrave të posaçme të votimit dhe administrimin e listës së zgjedhësve në IEVP, si dhe krijimin e komisioneve të qendrës së votimit për zgjedhjet për Kuvend.

Gjithashtu është parashikuar që votimi në IEVP të zhvillohet në prani të personelit të policisë së burgjeve, KQV-së dhe vëzhguesve, duke siguruar që procesi të jetë i rregullt dhe i sigurt.

Një nga pikat e këtij projektvendimi është zgjidhja e ngërçit që çoi në anulimin e zgjedhjeve në Rrogozhinë. Ndërsa Kolegji Zgjedhor arsyetoi se burgju është thjesht "vendqëndrim" dhe nuk krijon lidhje me komunitetin lokal, neni 18 i ri i ligjit për gjendjen civile krijon një situatë të re juridike duke e quajtur "vendbanim" për efekte zgjedhore. Projektvendimi e integron këtë koncept në Nenin 3, duke i dhënë të burgosurve të drejtën të votojnë për Kryetarin e Bashkisë ku ndodhet IEVP.

Kolegji Zgjedhor konstatoi se në vitin 2023, IEVP-ja e dërgoi listën e zgjedhësve vetëm 54 ditë para zgjedhjeve, duke shkelur afatin 60-ditor të Nenit 54 të Kodit Zgjedhor. Projektvendimi i paraqitur për miratim (Neni 3, pika 4) sanksionon rreptësisht afatin 50-ditor për dërgimin e listës nga Drejtuesi i IEVP-së të Bashkia dhe DPGJC-ja, duke shmangur çdo mundësi për rrëzim të listës në rrugë gjyqësore duke e sjelle në kohezion me pikën 2 të nenit 18 të Ligjit nr. 10129 "Për Gjendjen Civile" (i ndryshuar), pra duke e harmonizuar me ndryshimet e reja ligjore.

Projektakti detajon një procedurë me pesë hapa që përfshin bashkërendimin e IEVP-së, Bashkisë dhe DPGJC-së:

1. Identifikimi i IEVP-së si zonë qendre votimi nga Kryetari i Bashkisë.
2. Përgatitja e listës nga Drejtuesi i IEVP-së 50 ditë para zgjedhjeve.

3. Verifikimi dhe konfirmimi i listës nga Bashkia dhe DPGJC-ja 40 ditë para zgjedhjeve.
4. Dërgimi i listës finale te KZAZ-ja.
5. Afishimi i listës brenda IEVP-së.

Miratimi i këtij akti siguron që zgjedhjet në institucionet e posaçme të jenë të qëndrueshme ndaj çdo ankimi dhe të garantojnë të drejtën universale të votës për shtetasit që vuajnë dënimin penal.

Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim, projektvendimin “Për miratimin e rregullave për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimin e listës së zgjedhësve dhe krijimin e komisionit të qendrës së votimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për zgjedhjet për organet e veteqeverisjes vendore”.

Erion META – Drejtor Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Blendi KODRA – Drejtor Drejtoria e Ligjshmërisë

Jona JOSIFI – Sekretar i Përgjithshëm (Ne mungese me autorizim)

Statistika te dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

	IEVP	Të burgosur me të drejtë vote (Nr)		Të burgosur që janë subjekt i ligjit Nr. 138/2015		TOTAL TE BURGOSUR
		Të paraburgosur	Të dënuar	Të paraburgosur	Të dënuar	
1	IVSHB	0	0	0	0	0
2	Kavajë	3	2	0	2	7
3	Burrel	41	5	0	90	136
4	Peqin	108	0	0	256	364
5	Pojskë	38	2	0	24	64
6	Tepelenë	83	0	0	0	83
7	Elbasan	135	0	0	0	135
8	Kukës	25	0	0	0	25
9	Rrogozhinë	0	203	0	30	233
10	Lushnjë	0	51	0	67	118
11	Lezhë	0	0	0	0	0
12	Fier	418	92	0	298	808
13	Korçë	211	18	0	147	376
14	Durrës	180	4	0	51	235
15	Berat	88	0	0	0	88
16	Shkodër	298	45	0	299	642
17	Mine Peza	152	0	0	5	157
18	Fushe Krujë	306	3	0	25	334
19	Vlorë	132	1	0	0	133
20	Jordan Misja	389	3	63	0	455
Totali		2607	429	63	1294	4393

3036

1357